



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Dep.	Prot No.
Nr. i faq.	01-1000/15
Broj stranica	Data
Nr. pages	Datum
	Date
PRISHTINË	

70

02

02.04.2015



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.04.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me nr. AKK- 03 – 02-336/15, për z. Anton Gegaj – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Istogut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 –02 - 336/15, për zyrtarin e lartë z. Anton Gegaj – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Istogut, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Gegaj është hetuar për konflikt interesit për shkak se, krahas ushtrimit të funksionit publik si Drejtor në Komunën e Istogut, ka qenë edhe person i autorizuar në biznesin privat “Medicus - AG”.

Fillimisht zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrimit të gjendjes së konfliktit të interesit, pas së cilës është takuar me zyrtarët e Agjencisë, për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj në mënyrë që të shmangë këtë situatë.

z. Gegaj është bindur për kufizimin si person i autorizuar në biznesin privat dhe ka premtuar që do t'i bëj ndryshimet e këruara për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Ndërkohe ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 02/916/15), me të cilën vërtetohet se ka bërë ndryshimet e nevojshme. Me këtë z. Gegaj kashmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni



[Handwritten signature over the stamp]